



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.30/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Fejzullah Rexhepi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të parashtruesve të apelit- subjektet politike Nasha Iniciativa, me seli në Mitrovicë, Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat, me seli në Prizren si dhe Nova Demokratska Stranka me seli në Prizren, të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 të dt. 04.03.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me rezultatin përfundimtar të publikuar më datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 14.02.2021, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hodzic dhe ankesës se subjekti politik Social Demokratska-UNIJA SDU, të paraqitura kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.656/2021, të datës 07.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Lëndët e regjistruara në Gjykatën Supreme, sipas ankesës se subjektit politik Ujedinjena Zajednica-Adrijana Hodzic, me numër AA.nr.30/2021, dhe sipas ankesës së subjektit politik Social Demokratska-UNIJA SDU, me numër AA.nr.34/2021, të paraqitura kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.656/2021, të datës 07.03.2021, bashkohen në një lëndë dhe udhëhiqen me shenjë e përbashkët AA.nr.30/2021.

REFUZOHEN të pabazuar ankesa e subjektit politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic dhe ankesa e subjektit politik Social Demokratska-UNIJA SDU, të paraqitura kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.656/2021, të datës 07.03.2021.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.656/2021, të datës 07.03.2021, janë pranuar pjesërisht të bazuara apelet Anr.656/2021, A.nr.733/2021 dhe A.nr.735/2021, të paraqitura nga subjektet politike Nasha Iniciativa, Unioni Social Demokrat dhe Nova Demokratska Stranka të datës 05.03.2021 kundër vendimit të KQZ-së nr.860-2021, të datës 04.03.2021, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtur me 14 Shkurt 2021.

Në pikën I (një) është vendosur që të ANULOHEN në tërësi votat për subjektet politike boshnjake në këto Komuna: Zubin Potok, Shtërpçë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Kllokot dhe Novobërdë dhe atë:

Për subjektin politik Ujedinjina Zajednica - Adrijana Hodzic,

- në Komunën e Zubin Potokut 407 fletëvotime
- në Komunën e Shtërpçës 499 fletëvotime
- në Komunën e Ranillugut 255 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 416 fletëvotime
- në Komunën e Parteshit 196 fletëvotime
- në Komunën e Kllokotit 249 fletëvotime
- në Komunën e Novobërdës 254 fletëvotime

Për subjektin politik Koalicioni – VAKAT

- në Komunën e Shtërpçës 8 fletëvotime
- në Komunën e Ranillugut 211 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 6 fletëvotime
- në Komunën e Parteshit 34 fletëvotime
- në Komunën e Kllokotit 9 fletëvotime
- në Komunën e Novobërdës 255 fletëvotime

Për subjektin politik Social Demokratska - UNIJA SDU

- në Komunën e Shtërpçës 1 fletëvotime
- në Komunën e Ranillugut 4 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 11 fletëvotime
- në Komunën e Kllokotit 147 fletëvotime, (me korrigjim të vendimit 2 fletëvotim),
- në Komunën e Novobërdës 2 fletëvotime

Për subjektin politik Nasha Iniciativa- Nasha

- në Komunën e Shtërpçës 4 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 5 fletëvotime

Për subjektin politik Nova Demokratska Stranka

- në Komunën e Shtërpçës 2 fletëvotime
- në Komunën e Ranillugut 1 fletëvotime
- në Komunën e Graçanicës 6 fletëvotime
- në Komunën e Kllokotit 2 fletëvotime
- në Komunën e Novobërdës 3 fletëvotime

Në pikën II (dy) është vendosur që të ANULOHEN pjesërisht votat për subjektet politike Ujedinjena Zajednica- Adrijana Hodzic dhe Koalicioni VAKAT dhe atë:

Për subjektin politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic:

- në Komunën e Zvecanit 157 fletëvotime
- në Komunën e Leposavicit 973 fletëvotime
- në Komunën e Mitrovicës së Veriut 799 fletëvotime

Për subjektin politik Koalicioni - VAKAT:

- në Komunën e Leposavicit 60 fletëvotime.

Ndërsa pjesa tjetër e kërkesës në ankesë për anulimin e të gjitha votave përtej pjesës aprovuese si në pikën I (një) dhe II (dy), të dispozitivit të vendimit janë refuzuar të pabazuara.

Në pikën III (tre) të dispozitivit është URDHËRUAR Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që votat e përfshira nga fletëvotimet e anuluar si në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit të këtij vendimi, t'i largojë nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 04.03.2021.

Kundër vendimit të lartpërmendur Ujedinjina Zajednica - Adrijana Hodzic, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të konsiderueshme kushtetuese dhe për shkak të shkeljeve të konsiderueshme të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me propozim që të:

“I. Gjykata të miratoj ankesën si të bazuar

II. Të vërtetoj se vendimi i PZAP, Anr.656/2021, i datës 7 mars 2021, është në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr.2008/03-L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës.

III. Të shfuqizoj vendimin e PZAP, Anr.656/2021, i datës 7 mars 2021, si të paligjshëm dhe antikushtetues.

IV. Të vërtetoj vendimin përfundimtar nr.860-2021, të datës 4 mars 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mbi shpalljen e rezultateve përfundimtare për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura me 14 shkurt 2021”.

Kundër vendimit të lartpërmendur edhe Social Demokratska-UNIJA SDU ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor për shkak të cenimit të drejtave themelore, me propozim që të:

“Gjykata Supreme e Kosovës të anuloj të gjitha votat e fituara nga subjekti politik Ujedinjina Zajednica - Adrijana Hodzic në komunat me shumicë serbe: Leposaviq, Zveqan dhe Mitrovicë të veriut, si dhe të korrigjoj gabimin teknik në dispozitivin e vendimit të ankimuar, ashtu që të subjekti politik Demokratska-UNIJA SDU, në komunën e Kllkotit ku “anulohen 147 fletëvotime të përcaktohet se anulohen vetëm 2 fletëvotime, aq vota sa ka marrë subjekti politik”

PZAP, më përgjigjet në ankesat e paraqitur ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e subjekteve politike, ndërsa vendimi i PZAP, Nr.656/2021, i datës 07.03.2021, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat e subjektit politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic dhe ankesa e subjektit politik Social Demokratska-UNIJA SDU , të paraqitura kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), Anr.565/2021, të datës 07.03.2021, janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se më vendimin e KQZ-së, me nr. 860/2021, të datës 04.03.2021, është shpallur rezultati përfundimtar për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikë së Kosovës, të mbajtura më datën 14.02.2021.

PZAP më datë 05.03.2021, ka pranuar apelet nga subjektet politike Nasha Iniciativa, me seli në Mitrovicë, Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat, me seli në Prizren si dhe Nova Demokratska Stranka me seli në Prizren, të paraqitura kundër vendimit të KQZ-së, me nr. 860/2021, të datës 04.03.2021, me të cilin është shpallur rezultati përfundimtar për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikë së Kosovës, të mbajtura më datën 14.02.2021.

PZAP, pas shqyrtimit të apeleve Anr.656/2021, Anr.733/2021 dhe Anr.735/2021, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të kundërshtuar A.nr.656/2021, i datë 07.03.2021.

Për mënyrën e vendosje si në vendimin e kundërshtuar, PZAP ka arsyetuar se:

Paneli, me datë 06.03.2021, sipas detyrës zyrtare, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar gjendjen faktike dhe ka arrite në përfundim se ankesat janë pjesërisht të bazuara, për arsye se: Votat e marra nga Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic dhe Koalicioni - VAKAT, janë në disproporcion me numrin e banorëve të komunitetit boshnjak, komunitet që i përkasin edhe subjektet ankuese por edhe subjekti i atakuar, paraqesin vota të pa vlefshme, për faktin se është standard jodemokratik, që me votat e votuesve të një komunitetit të sigurohet e drejta e përfaqësimit të një komuniteti tjetër dhe si të tilla nuk paraqesin lidhje objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar.

Për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, subjekte të caktuara si në këtë rast Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic dhe Koalicioni - VAKAT kanë marrë shumicën e votave nga komuniteti serb, gjë që në këtë rast paraqet devijim të vullnetit të votuesit të komunitetit boshnjak, e krejt kjo në thelb paraqet minim të procesit zgjedhor por edhe të integritetit të këtij procesi.

Sipas vlerësimit të Panelit, minimi i procesit zgjedhor përmes votimit në këtë mënyrë të orkestruar për subjekte të caktuara për të zgjedhur përfaqësuesit e komunitetit boshnjak, përveç devijimit të vullnetit të votuesit, kjo në vetvete cenon demokracinë e brendshme zgjedhore, eliminon garën në mes të subjekteve për vendet e garantuara dhe krejt kjo është në kundërshtim me nenin 111.1 të LZP-së, nenin 58.4 të Kushtetutës së Kosovës dhe parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore evropiane. Për vendet e rezervuara është me rëndësi lidhja objektive në mes të votuesit dhe subjektit të votuar, dhe vetëm kështu sigurohet e drejta e përfaqësimit në kuptim të dispozitave të LZP-së, dhe në frymën e dispozitave dhe standardeve kushtetuese.

Vendet e rezervuara janë garanci kushtetuese të cilat Republika e Kosovës i ka marr, me të vetmin qëllim për trajtimin e avancuar të të drejtave të pakicave në kuadër të institucioneve shtetërore.

Se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara të fituara nga votues të komunitetit tjetër vërtetohet nga numri i banorëve në krahasim me numrin e votave të marra, ndërsa numri i banorëve pasqyrohet përmes të dhënave të marra nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së.

Paneli, ka shtuar së në raport me pakicat ekzistojnë standarde ndërkombëtare sipas të cilave shtetet përkatëse duhet të themelojnë praktika apo mekanizma të atillë, që u mundësojnë pjesëtareve të pakicave votim të lirë, krijimin e subjekteve të tyre si dhe parandalimin e çdo lloj diskriminimi për të zgjedh dhe për tu zgjedhur. Është fakt notor se përqindja e qytetarëve të komunitetit boshnjak, shqiptar, etj., nuk ka shënuar rritje në këto komuna si: Mitrovicë e Veriut, Zvecan, Zubin Potok dhe Leposavic, për shkak të rrethanave dhe funksionimit të këtyre komunave.

Paneli ka konstatuar se në bazë të raportit të OSBE-së, i vitit 2018 (*i cili raport merret i besueshëm, për shkak se është organizatë kredibile, dhe ka qëndrim neutral ndaj të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës*) numri i banorëve të komunitetit boshnjak në komunat veriore është si vijon: Mitrovicë e Veriut 1,000 banorë, Zvecan 300, Zubin Potok nuk ka, Leposavic 350 banorë, ndërsa numri i votave për komunitetin boshnjak në këto Komuna është në disproporcion me numër të banorëve.

Tendenca për krijimin e praktikave të tilla të votimit masiv nga pjesëtarët e njërit komuniteti për subjektin e komunitetit tjetër, paraqet praktikë të rrezikshme e cila në të ardhmen do të mund të shfrytëzohej nga komuniteti shumicë, për t'ia pamundësuar të drejtën e përfaqësimit në mënyrë objektive komuniteteve tjera pakicë.

Anulimi i pjesshëm i votave për subjektet e cekura si në dispozitiv të këtij vendimi, ka për qëllim ruajtjen dhe garantimin e të drejtës së përfaqësimit, në raport me përqindjen e popullsisë nga ky komunitet sikurse garantohet me ligj dhe Kushtetutë.

Përveç të cekurave, Paneli ka vlerësuar dhe ka marr për bazë në mënyrë krahasimore edhe të dhënat për votuesit në zgjedhjet paraprake (2017 dhe 2019) në raport me zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021. Paneli, duke iu referuar të gjeturave të konstatuara më lartë ka vendos si në pikën I (një) dhe të II (dy) të dispozitivit të vendimit, e në veçanti duke u bazuar në raportet e OSBE-së, për strukturën demografike të popullsisë boshnjake nga të cilat rezulton se në vitin 2018 komuniteti boshnjak ka pasur numër të banorëve të përshkruar si në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar.

Paneli, ka vendosi si në pikën I (një) të dispozitivit të vendimit, në 7 (shtatë) komunat e lartcekura duke anuluar në tërësi të gjitha votat e fituara nga të gjitha subjektet politike boshnjake, për arsye se votat e fituara janë në disproporcion dhe nuk korrespondojnë me numrin e banorëve të komunitetit boshnjak si dhe për arsye të cekura si më lartë.

Paneli, ka vendosi si në pikën II (dy) të dispozitivit të vendimi, në 3 (tri) komunat e lartcekura duke anuluar pjesërisht votat e fituara nga subjektet politike boshnjake, duke iu referuar raporteve të lartcekura, duke marr për baze strukturën demografike të popullsisë, gjegjësisht numrin e banorëve në raport me maksimumin e votave që do të mund të fitonin subjektet politike boshnjake në proporcion me numrin e banorëve të komunitetit boshnjak, si dhe për arsye të cekura më lartë. Sipas vlerësimit të Panelit në raport me pjesën refuzuese pala ankuese nuk e ka bërë të besueshme me prova bindëse kërkesën, sepse anulimi i të gjitha votave edhe në komunat ku përqindja e popullsisë së pjesëtarëve të komunitetit boshnjak është më e lartë, do të përbënte anulim të pa bazuar të fletëvotimeve të vlefshme, pasi jo të gjitha votat për komunitetin boshnjak kanë qenë të orkestruara. Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafët 2 dhe 3, neni 119 paragrafi 5, neni 120 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, mbi rrethanat faktike dhe juridike të konstatuara dhe vlerësuar nga Paneli, por edhe sipas pretendimeve ankimore të parashtruara nga subjektet politike ankuese, gjen se, qëndrimi dhe përfundimi i PZAP është i drejtë dhe i ligjshëm. Në këtë kontekst Gjykata Supreme, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në vendimin e PZAP, pasi që vendimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës, gjendja faktike e çështjes është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe rrjedhimisht është kualifikuar në mënyrë të drejtë e të plotë me të drejtën materiale.

Vendimi i kontestuar nga subjektet politike ankuese në këtë çështje në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, ndërsa përfundimi ka mbështetje të plotë në arsyet e dhëna nga Paneli, si për gjendjen faktike të çështjes, për procedurën e hetimit nga Paneli, e po ashtu edhe për të drejtën e zbatuar me rastin e vendosjes për apelet e subjekteve politike.

Në këtë kontekst vlerësohet se vendimi i kundërshtuar ka kronologji dhe koherencë si për aspekte faktike të çështjes ashtu edhe për aspektet juridike të çështjes, me arsye të plota dhe bindëse për secilin fakt të konstatuar, peshën që ka secili fakt i konstatuar në vendimmarrjen e Panelit, për mjete provuese të shfrytëzuara, për fuqinë provuese të mjeteve provuese të shfrytëzuara dhe për mënyrë se si paneli ka arrit në përfundimin lidhur me apelet e subjekteve politike.

Gjykata Supreme, e pranon në tërësi gjendjen faktike të konstatuar nga PZAP, pasi që me provat që gjenden në shkresat e lëndës, provohet në mënyrë të plotë dhe të besueshme gjendja faktike e konstatuar nga PZAP. Nga provat në shkresat e lëndës respektivisht nga hetimi i Panelit, është provuar se numri i votave të fituara nga subjekti politik Ujedinjina Zajednica - Adrijana Hodzic, nuk përputhet me numrin e votuesve të komunitetit për të cilin ka konkurruar, si përfaqësues në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 14 shkurtë 2021, në Komuna të caktuara. Nga provat që ka siguruar Paneli, veçanërisht nga raporti i OSBE, ka rezultuar se numri i banorëve të komunitetit boshnjak në komunat veriore është si vijon: Mitrovicë e Veriut 1,000 banorë, Zvečan 300, Zubin Potok nuk ka, Leposavic 350 banorë, ndërsa numri i votave për komunitetin boshnjak në këto Komuna është në disproporcion me numrin e banorëve në masë të theksuar.

Kjo rrethanë është konfirmuar edhe me krahasimet e të dhënave për votuesit në zgjedhjet paraprake (2017 dhe 2019) në raport me zgjedhjet e 14 Shkurtit 2021.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, të dhënat e siguruar nga hetimi i panelit në këtë rast kanë krijuar figurë të plotë faktike të çështjes për të dhënë vlerësimin përfundimtar lidhur me apelet e subjekteve politike, përkitazi me rezultatin e subjekteve politike Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic dhe subjekteve tjera të cilat konkurrojnë për vendet e rezervuara për komunitetin boshnjak, prandaj edhe është pranuar në tërësi gjendja faktike e konstatuar nga paneli.

Pretendimet ankimore të subjektit politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic, lidhur me të drejtën e zbatuar janë të pathemelta, për arsyet si në vijim:

Gjykata Kushtetuese në rastin nr.KI207/19, thekson se:

“124. Bazuar në dispozitat kushtetuese të cekura më lart, rezulton që gjykatat e rregullta kanë të drejtë dhe për më tepër obligim që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjykojnë, fillimisht sipas Kushtetutës, e pastaj sipas ligjit.

125. Gjithashtu, duke pasur parasysh hierarkinë e normave ligjore që u sqarua më lart, që Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Kosovë dhe se ligjet dhe aktet tjera duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën, Gjykata thekson se gjykatat e rregullta janë të obliguara që të interpretojnë normat ligjore në harmoni me normat kushtetuese.

126. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e Kushtetutës nuk ndikon në juridiksionin dhe autorizimet që i janë dhënë Gjykatës Kushtetuese sipas 112 të Kushtetutës, si autoritetit përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

127. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se Gjykata Kushtetuese sipas Kushtetutës është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës. Përmbajtja e nenit 112 të Kushtetutës, cituar më lart, dërgon në përfundimin e qartë se Gjykata Kushtetuese është organ publik me autorizim ekskluziv kushtetues për të interpretuar përfundimisht Kushtetutën dhe për të interpretuar përfundimisht përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën – gjë që nënkupton se para saj edhe autoritetet e tjera publike mund të angazhohen në interpretim kushtetues. Megjithatë, mënyra e interpretimit, si për nga procedura ashtu edhe për nga substanca, që autoritetet e tjera publike, duke përfshirë gjykatat e rregullta i kanë bërë Kushtetutës, gjithmonë mund të kontestohet para Gjykatës Kushtetuese. Në ato rrethana, Gjykata Kushtetuese do të jap interpretimin përfundimtar duke u pajtuar apo duke mos u pajtuar me interpretimin që i është bërë Kushtetutës paraprakisht”.

Në kontekstin e vlerësimeve që ka dhënë Gjykata Kushtetuese në rastin e referuar, Gjykata Supreme thekson se ligjshmëria e vendimit të kontestuar të Panelit, në këtë rast bëhet duke vlerësuar pasojat juridike që përcaktojnë me rastin e zbatimit dispozitat kushtetuese dhe dispozitat ligjore të referuar për çështjen konkrete.

Kjo nënkupton se vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të kontestuar të panelit është bërë sipas interpretimit nëse normat e zbatuara ligjore janë në harmoni sipas interpretimit me normat kushtetuese. Për rrjedhojë, referencat e Panelit në dispozita kushtetuese nuk janë vlerësuar nga ana e Gjykatës Supreme në kontekstin nëse Paneli ka juridiksion që përfundimin për apelet ta mbështes në dispozita kushtetuese, por janë vlerësuar nëse referencat ligjore sipas gjendjes faktike të konstatuar janë bazë e mjaftueshme për vendosjen e apeleve të subjekteve politike në mënyrën se si ka vendos Paneli në këtë rast dhe nëse interpretimi i dispozitave ligjore është në harmoni me dispozita kushtetuese të referuar por edhe të dispozitave tjera kushtetuese të cilat mund të jenë bazë për ta pranuar përfundimin e Panelit.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me dispozita e nenit 111 përcakton se: “111.1 Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë:

a) njëqind (100) vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë ato; dhe

b) njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:

(i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara” ndërsa në nenin 3 të ligjit të njëjtë janë dhënë përkufizimet për qëllim të ligjit, me ç’ rast përveç përkufizimeve tjera përcaktohet se:” **“Komuniteti”** do të thotë banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar, etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës” kurse në nenin 15.11, përcaktohet se:” Çdo subjekt politik në kërkesën e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo-shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës”.

Dispozitat e cituara me sipër, nga Paneli janë interpretuar në harmoni me dispozitat kushtetuese me referencë në dispozitat nga neni 64 i Kushtetutës, për shkak se përmbajtja është pothuajse identike, andaj në kuptimin përmbajtjesor për meritat e rastit (*lidhur me apelet e subjekteve politike*) dispozita e sipërcituara edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, përcaktojnë detyrimin e respektimit të vendeve të garantuara për komunitetet sipas sistemit të përfaqësimit të caktuara në nenin 64, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me ç’ rast njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Në rastin konkret kontestimi i rezultatit përfundimtar sipas vendimit të KQZ-së, nr.860/2021, të datës 04.03.2021, nuk qëndron në rrethanë nëse subjekti politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic, është subjekt politik i certifikuar për njëzet (20) vende që janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, në këtë rast për komunitetin boshnjak, por kontestimi qëndron në atë se, nëse ky subjekt politik më votat e fituara për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 14 shkurtë përfaqëson komunitetin boshnjak. Në frymën e dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkufizimi i nocionit “komunitet” lehtëson procesin e interpretimit të dispozitave ligjore dhe procesin e vlerësimit nëse subjekt në fjalë më votat e fituara e përfaqësojnë komunitetin boshnjak dhe rrjedhimisht edhe procesin e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar të PZAP.

Në këtë kontekst, ashtu siç është theksuar edhe me sipër, përkufizimi **“Komuniteti”** do të thotë *“banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar, etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës”* andaj për rrjedhojë duhet të merren në konsideratë faktet e konstatuara nga Paneli, nëse subjekti politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic, i certifikuar si subjekt politike për njëzet (20) vende që janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, në këtë rast për komunitetin boshnjak, është bërë subjekt fitues për ndonjërin nga vendet e rezervuar për komunitetin boshnjak me votat e këtij komuniteti, apo ka fituar ndonjërin nga vendet e rezervuara për komunitetin boshnjak me votat e një komuniteti tjetër.

Paneli në bazë të hetimit ex-officio, ka konstatuar fakte thelbësore të mjaftueshme përmes provave të mbledhura të cilat edhe nga Gjykata Supreme, çmohen si kredibile, e në bazë të cilave provohet se subjekti politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic, i certifikuar si subjekt politike për vendet e rezervuara të komunitetit boshnjak, ka fituara ulëse në Kuvendin e Kosovës me votat e votuesve të një komuniteti tjetër.

Në situatën e krijuar, vlerësimi mbi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar të Panelit, del nga vlerësimi përfundimtar nëse duhet të pranohet pretendimi i subjektit ankues Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic, se e drejta e votës është e drejtë kushtetuese dhe se vullneti i shprehur i votuesve është përcaktues për vendet e fituara, pa marrë parasysh se për cilat vende bëhet fjalë, apo sipas vlerësimit përfundimtar nëse duhet të pranohet si i bazuar pretendimi i subjekteve politike që kanë parashtruar alpet dhe që pretendojnë se për vendet e rezervuara, përveç se subjektet duhet të jenë të certifikuar për ato vende, të njëjtat subjekte ato vende duhet ti fitojnë me vota të votuesve të komuniteteve për të cilat konkurrojnë në Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës .

Gjykata Supreme e ka pranuar përfundimin e Panelit, pasi që ka vlerësuar se në këtë rast është paraqitur fenomeni i votimit në mënyrë masive nga votuesit e një komuniteti për kandidatet e certifikuar të një subjekti politik për vendet e rezervuara të komunitetit tjetër dhe në këtë mënyrë është pamundësuar përfaqësimi i komunitetit boshnjak nga përfaqësues të cilët dalin fitues të vendeve të rezervuara për komunitetin në fjalë, sipas vullnetit të votuesve të atij komuniteti.

Për të dhënë këtë vlerësim Gjykata Supreme, ka marrë në konsideratë specifikat e të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, dhe garancionet kushtetuese që ekzistojnë për të drejtat e përfaqësimit të secilit komunitet që jeton në Republikën e Kosovës.

Ka qenë edhe pretendim në apelet e paraqitura pran PZAP, se për realizimin efektiv të demokracisë konsociacionale nuk mjafton vetëm deklarimi se personi përfaqëson një komunitet të caktuar, por duhet të ekzistoj edhe lidhja objektive në mes të këtij deklarimi dhe përkatësisë së dhënë etnike, gjuhësore, fetare, nacionale, etj., gjë që është marrë në konsideratë në vlerësimin e Gjykatës Supreme, sepse në këtë frymë ekziston edhe vendimi i Gjykatës Supreme, me shenjen AA.nr.6/2021, i datës 28.01.2021, me të cilin ishte refuzuar ankesa e subjektit politik, Nova Demokratska Stranka, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Anr.14/2021, i datës 25.01.2021, me të cilin është prishë vendimi me nr.225/2021, i datës 22.01.2021, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe është decertifikuar kandidati Emin Neziraj, nga lista e kandidatëve të certifikuar për deputet të subjektit politik Nova Demokratska Stranka, me seli në Prizren.

Në këtë vendim të referuar, Gjykata Supreme ka mbajtur qëndrimin se deklarimi i personit si kandidat për përfaqësues të një komuniteti nuk është i mjaftueshëm për tu certifikuar si kandidat për vendet e rezervuara për atë komunitet, sepse nëse kandidati nuk ka një lidhje objektive me komunitetin në kuptimin e përkatësisë etnike, nuk do të plotësoj konditat e përfaqësuesit për komunitetin e dhënë për vendet e rezervuara.

Ky qëndrim i Gjykatës Supreme, është në frymën e premisave të cilat e përbëjnë konceptin e demokracisë konsociacionale, e që nënkupton ndarjen e pushtetit midis grupeve të ndryshme të shoqërisë në një vend të caktuar. Sipas këtij koncepti sendërtohen mekanizmat e qëndrueshmërisë politike në një shoqëri më ndarje sipas grupeve të ndryshme veçanërisht etnike, pa përjashtuar ato gjuhësore, fetare etj.

Në Kushtetutën e Republikës, përmes vendeve të rezervuara për komunitet jo shumicë është synuar përfaqësimi i të gjitha grupeve në organin përfaqësues, andaj për këtë përfaqësimi duhet të ekzistoj lidhje objektive në mes të përfaqësuesve dhe votuesve të komunitetit përkatës, përndryshe deformohet përfaqësimi efektiv i komuniteteve për të cilat Kushtetuta ka garantuar vendet e rezervuara, e për të cilat vende nuk ekziston sa i përket subjekteve të certifikuara pragu zgjedhor.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë rast përmes këtij interpretimi, nuk promovon konceptin e demokracisë konsociacionale përtej kornizës kushtetuese, por interpreton se dispozitat ligjore dhe kushtetuese për vendet e rezervuara kanë premisa të këtij koncepti, e të cilat e diktojnë ruajtjen e përfaqësimit efektiv të komuniteteve përmes mekanizmave të cilat në radhë të parë garantojnë të drejtën e votës, por brenda kësaj kornize edhe të drejtën e përfaqësimit për komunitetet nga përfaqësues me lidhje objektive me komunitetin, posaçërisht lidhja e përkatësisë etnike, pa përjashtuar edhe gjuhen, etj.

Me dispozitat e nenit 58 të Kushtetutës, janë përcaktuara Përgjegjësit e Shtetit, ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: *“Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit”*.

Nga dispozita e cituar del detyrimi i shtetit të Kosovës, për miratimin e masave adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve, andaj nëse do të tolerohej fenomeni i votimit masiv nga votuesit e një komuniteti për kandidatët e certifikuar të komunitetit tjetër, në çdo rast përfaqësimi efektiv i çdo komunitetit substancialisht do të rrezikohet, nëse komuniteti tjetër ka ma shumë votuese. Ky fenomen i shfaqur, nëse do të tolerohej do të mund të shndërrohej lehtësisht në një praktikë të pamundësisë për të fituar vendet e rezervuara nga kandidatët të cilët kanë lidhje objektive me komunitetin dhe të cilët votohen nga komunitetit me të cilin kandidati ka lidhje objektive. Kjo për shkak se komunitetet i kanë vendet e rezervuara dhe ato vende nuk rrezikohen edhe nëse nuk kanë votues proporcionalisht me vendet e rezervuara, prandaj çdo komunitet që ka votues ma shumë se komunitetet tjetër mund të shfrytëzoj këtë formë të veprimit për të diktuar pastaj sjelljen e përfaqësuesve të cilët kanë fituar vendet me votat e komunitetit tjetër. Të njëjtën gjë mund ta shfrytëzojnë edhe subjektet të cilat konkurrojnë për vendet që nuk janë të rezervuara, duke shfrytëzuar lidhjet me votuesit deri në masën që do të mund t'i orientonin se për cilët kandidat duhet të votojnë.

Gjykata Supreme, duke marrë në konsideratë edhe detyrimet që burojnë nga Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e zbatueshme drejtpërdrejtë sipas nenit 22, të Kushtetutës, në këtë rast vlerëson se mënyra e vendosjes në PZAP, për anulimin e tërësishëm të votave për subjektin politike Ujedinjina Zajednica, në komunat Zubin Potok, Shtërpcë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Klllokot dhe Novoberrdë, ndërsa pjesërisht në komunën e Zveqanit, Leposaviqit dhe Mitrovicës së Veriut, është përfundim i nxjerr nga dispozitat e zbatuara ligjore e të interpretuara në frymën e dispozitave kushtetuese, si masë për ruajtjen e përfaqësimit efektiv të komunitetit boshnjak, përmes përfaqësuesve të cilët legjitimohen si fitues nga vota e votuesve të atij komuniteti, si kandidat përfaqësues të se cilit konkurrojnë. Në këtë kontekst vlerësohet se në mungesë të masave shtesë teknike të aprovuara nga ana e shtetit për mënyrën e votimit, për të ruajtur përfaqësimin efektiv të komuniteteve, atëherë rezulton se mënyra se si PZAP, ka vendosur në situatën e krijuar, paraqet masë reale dhe zgjidhje të pranueshme për të ruajtur përfaqësimin efektive, andaj në situatën e krijuar është zgjidhja e vetme e pranuar në tërësi si e drejtë dhe e ligjshme.

Gjykata Supreme i ka pranuar arsyet e dhëna nga Paneli, edhe për rastin e anulimit të tërësishëm të votave, por edhe për anulimin e pjesshëm. Vlerësohet se në rastin e anulimit të tërësishëm të votave nuk është rrezikuar fare vota e votuesve të komunitetit boshnjak, ndërsa në rastin e anulimit të pjesshëm, kriteri i pranuar nga PZAP, që vota të anulohen deri në masën proporcionale me votuesit e komunitetit boshnjak, është zgjidhje reale dhe në funksion të ruajtjes së çdo vote të votuesve të komunitetit boshnjak, sepse nuk mund të paragjykohet fakti nëse votuesit e komuniteti boshnjak e kanë ushtruar të drejtën e votës në komunat ku anulimi është i pjesshëm.

Janë vlerësuar edhe pretendimet ankimore se me vendimin e PZAP, janë cenuar të drejtat e qytetarëve të Kosovës, duke u vendosur në pozitë të pabarabartë, mirëpo një pretendim i tillë nuk është pranuar si i themeltë sepse me vendimin e PZAP nuk janë cenuara vendet e rezervuara për komunitete, përkundrazi është mundësuar që përfaqësimi i komuniteteve të bëhet me legjitimitet të votuesve për përfaqësues të legjitimuar, andaj kjo mënyrë e vendosje vlerësohet si ruajtje e standardeve demokratike të përfaqësimit.

Pretendimi se është cenuar përfaqësimi i komunitetit boshnjak përmes anulimit të votave, nuk është pretendim i qëndrueshëm, sepse PZAP është kujdesur që në bazë të të dhënave kredibile të siguruar nga hetimi, të ruaj çdo votë të votuesit nga komuniteti boshnjak, andaj nuk mund të konsiderohet se është cenuara përfaqësimi i këtij komuniteti, përderisa janë anuluar votat e votuesve të një komunitetit tjetër që kanë votuar për kandidatet e certifikuar për përfaqësimin e komunitetit boshnjak. Anulimi i votave sipas vendimit të PZAP nuk e cenon të drejtën e votuesit që i përket komuniteteve jo shumicë, madje vendimi i kundërshtuar avanco standardin e ruajtjes së balancave të vendosura në kushtetutë për të drejtën e përfaqësimit, prandaj kjo nënkupton se mekanizmat shtetëror nuk duhet të jene indiferent nga fenomene që rrezikojnë prishjen e balancave të përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës.

Arsyet e dhëna për refuzimin e ankesës së subjekti politik Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodzic, janë edhe arsye e refuzimit të ankesës së subjektit politik Social Demokratska-UNIJA SDU.

Sa i përket pretendimit të paraqitur nga subjekti politik Social Demokratska-UNIJA SDU, për anulimin e pjeshëm të votave në komunën e Klllokotit, PZAP, i ka dorëzuar Gjykatës Supreme aktvendimin korrigjues të datës 10.03.2021, me të cilin është korrigjuar gabimi teknik, i cili ishte pretendimi i subjektit politik në fjalë, ashtu që numri i fletëvotime i shënuar 147, është korrigjuar me numrin 2, dhe në këtë mënyrë konsiderohet i konsumuar ky pretendim.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet nga ankesat e të dy subjekteve politike, por Gjykata Supreme ka vlerësuar se nuk janë me ndikim për të vendosur ndryshe.

Për arsyet e paraqitura më lart, e në pajtim me nenin 118 pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
AA.nr.30/2021, datë 11.03.2021

Kryetar i kolegjit,
Albert Zogaj